



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA E MESME PROFESIONALE “HOTELERI-TURIZËM”
TIRANË

Nr. 278 Prot
Dt. 03.09.2025



RREGULLORE
E
KOMISIONIT TË DISIPLINËS TË
SHKOLLËS
“HOTELERI-TURIZËM”

VITI SHKOLLOR 2025-2026

Neni 1

Baza ligjore

Rregullorja e Komisionit Disiplinor të Institucionit shkolla “Hoteleri-Turizëm”, këtu më poshtë Komisioni, mbështetet në Ligjin nr. 15/2017 datë 16.02.2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 759, datë 30.9.2024 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit”, i ndryshuar si dhe në Rregulloren e brendshme të institucionit.

Neni 2

Fusha e zbatimit

Kjo Rregullore zbatohet brenda institucionit dhe e shtrin veprimin e saj mbi të gjithë personelin mësimdhënës, administrativ dhe nxënësit e institucionit. Çdo aspekt tjetër i cili nuk është parashikuar në këtë rregullore, rregullohet sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 3

Qëllimi

Komisioni shqyrton dhe miraton shkelje të disiplinës në marrëdhëniet e punës të personelit të institucionit, procesit mësimor, veprimtarisë së nxënësve të institucionit brenda institucionit si dhe shkeljet e konstatuara nga Komisioni i Etikës dhe Sjelljes. Komisioni shqyrton rastet e paraqitura para tij nga subjektet e legjitimuara dhe rast pas rasti vendos masat disiplinore të parashikuara në këtë rregullore.

Neni 4

Veprimtaria e Komisionit të Disiplinës

Komisioni e ushtron veprimtarinë e tij brenda institucionit dhe në përputhje me parashikimet e bëra në legjislacion në fuqi, në Rregulloren e brendshme dhe këtë rregullore. Komisioni angazhohet të mbikëqyr zbatimin me përpikëri të disiplinës në marrëdhëniet e punës dhe në procesin mësimor dhe praktikë brenda institucionit. Komisioni e shtrin veprimtarinë dhe juridiksionin e tij mbi personelin mësimor, mbështetës dhe nxënësve të institucionit.

Neni 5

Parimet mbi të cilat bazohet marrja e masave disiplinore

1. *Parimi i ligjshmërisë* nënkupton që rregullorja e brendshme e shkollës të parashikojë, së pari, sjelljet që bien në kundërshtim me jetën shkollore dhe procesin mësimor dhe, së dyti, masa përkatëse disiplinore që aplikohet për secilin rast. Për këtë, paraprakisht është e nevojshme që nxënësi të bindet nga struktura përkatëse që jep masën disiplinore, se masa disiplinore e dhënë ndaj tij mbështetet në rregulloren e brendshme të institucionit dhe se nuk është rezultat i një vullneti arbitrar.
2. *Parimi “ne bis in idem”* nënkupton që asnjë nxënës nuk mund t’u nënshtrohet disa masave ndëshkimore brenda institucionit për të njëjtat (fakte) gabime.

3. *Parimi i dialogut* nënkupton që institucioni arsimor ka për detyrë t'i krijojë nxënësit, personelit arsimor dhe punonjësve mundësinë e dialogut, duke dëgjuar argumentet e tij, para marrjes së çdo mase disiplinore ndaj tij nga komisioni i disiplinës në institucion. Zbatimi i këtij parimi shmang keqkuptimet e nxënësit, personelit arsimor dhe punonjësve, si dhe ndjenjën e padrejtësisë ndaj tij.
4. *Parimi i proporcionalitetit* nënkupton që aplikimi i masës disiplinore jepet në proporcion me shkallën e shkeljes së rregullores së brendshme të institucionit dhe lidhet me natyrën e shkeljes së kryer. Rrjedhimisht, masat disiplinore, si rregull, jepen gradualisht duke nisur nga më e lehta.
5. *Parimi i individualizimit* nënkupton marrjen parasysh të shkallës së përgjegjësisë së nxënësit në shkeljen e rregullave disiplinore. Në zbatim të këtij parimi duhet mbajtur parasysh, që:
 - a) nuk duhen zbatuar masa disiplinore kolektive, të cilat konsiderohen të pavlefshme, pasi nuk arrihet qëllimi edukativ i masës disiplinore;
 - b) në rastet kur shkeljet kryhen nga një grup nxënësish, komisioni i disiplinës për caktimin e masës disiplinore, duhet të përcaktojë shkallën e përgjegjësisë së çdo individi, me qëllim që të individualizohet masa disiplinore, e cila nuk përjashton mundësinë që mund të jetë identike për disa nxënës;
 - c) në rastet si më sipër të shkeljeve të tilla që përfshijnë disa nxënës, drejtori i institucionit krijon një grup pune të përbërë nga mësues, i cili mund t'i propozojë komisionit të disiplinës masa disiplinore edukative të personalizuar.
6. *Parimi i arsytimit të masës disiplinore* nënkupton detyrimin e komisionit të disiplinës për të arsyetuar masën disiplinore. Në zbatim të këtij parimi duhet mbajtur parasysh:
 - a) vendimi për çdo masë disiplinore duhet të përmbajë referencën ligjore mbi të cilën bazohet;
 - b) vendimi për çdo masë disiplinore të merret me shkrim dhe të argumentohet në mënyrë të qartë dhe të saktë.

Neni 6

Anëtarët e Komisionit të disiplinës

Komisioni i disiplinës ngrihet në çdo ofrues publik të arsimit dhe formimit profesional, në çdo fillim të vitit shkollor dhe përbëhet nga 5–7 persona.

Anëtarë në përbërje të komisionit të disiplinës janë drejtori i institucionit, një nga zëvendës drejtorët (nëse ka) dhe mësues të zgjedhur me votim të fshehtë nga këshilli i mësuesve, me shumicë të thjeshtë. Nëse ka më shumë se një zëvendës drejtor, Drejtori i institucionit zgjedh si anëtar të këtij Komisioni njërin prej tyre.

Komisioni i disiplinës kryesohet nga drejtori i ofruesit publik të AFP-së.

Këshilli i mësuesve zgjedh në fillim të vitit shkollor edhe një mësues që konsiderohet anëtar rezervë i këtij komisioni, vetëm në rastet kur njëri prej anëtarëve të tij mungon apo kur çështja që merr në shqyrtim komisioni, lidhet me një prej anëtarëve të tij.

Sekretari i komisionit zgjidhet me rotacion nga anëtarët e Komisionit një herë në tre muaj.

Neni 7

Largimi i anëtarit të Komisionit

Anëtari i komisionit largohet kur:

- a) jep dorëheqjen;
- b) shumica e anëtarëve vendosin përjashtimin e tij;

- c) për shkelje të normave të disiplinës, etikës dhe sjelljes që bien në kundërshtim me veprimtarinë e komisionit;
- d) kur vihet në dyshim integriteti i tij, për shkak të procedimeve administrative, civile, penale që vijnë ndaj tij;
- e) kur mungon në tri mbledhje radhazi në mënyrë të pajustificuar.

Neni 8

Funksionet e Kryetarit të Komisionit

Kryetari ka këto funksione:

1. Organizon dhe drejton veprimtarinë e Komisionit;
2. Nis procedimin disiplinor me kërkesë të subjekteve të legjitimuara;
3. Pranon kërkesë të tjera të subjekteve të legjitimuara (anëtarët e Bordit Drejtues, personelit të institucionit, prindërve dhe nxënësve) dhe pasi shqyrton dhe i verifikon ato i kërkon Komisionit fillimin e procedimit disiplinor brenda 5 (pesë) ditëve nga shqyrtimi i kërkesës;
4. Kryen procedurat për zëvendësimin e anëtarit të Komisionit në rast se gjendet në kushtet e parashikuara në nenin 7 të kësaj Rregulloreje, jo më vonë se 5 (pesë) ditë përpara datës së mbledhjes;
5. Kryeson mbledhjet dhe parashtron rastet përpara komisionit;
6. Siguron zbatimin me përpikëri të kësaj rregulloreje gjatë veprimtarisë së Komisionit.

Neni 9

Sekretari i Komisionit

Sekretari ka këto funksione:

1. Përcjell tek kryetari ankesat/kërkesat e paraqitura në sekretari;
2. Përgatit njoftimet për anëtarët për datën orën dhe rendin e ditës që do të zhvillohen mbledhjes së komisionit;
3. Përgatit dosjet me materialet e mbledhura rast pas rasti për anëtarët e Komisionit;
4. Mban procesverbalin për çdo mbledhje;
5. Mban një regjistër ku shënon të gjitha rastet e shkeljeve që trajton.

Neni 10

Forma e ankesës/ kërkesës

Komisioni vihet në lëvizje kryesisht, mbi bazën e një ankese/kërkese të subjekteve të legjitimuara ose referimit të çështjes nga Komisioni i Etikës dhe Sjelljes.

Kërkesa për fillimin e procedimit disiplinor i drejtohet në formë shkresore Komisionit nga subjektet e legjitimuara.

Kjo kërkesë i përcillet për shqyrtim Komisionit, i cili vlerëson nëse jemi përpara një shkelje disiplinore ose jo.

Shkresa drejtuar Komisionit duhet të identifikoj kërkuuesin, identitetin e shkelësit të pretenduar të disiplinës si dhe shkeljen e pretenduar. Sipas rastit, shkresës mund ti bashkëlidhen dhe dokumente apo prova të tjera që shërbejnë për të mbështetur pretendimin e ngritur.

Neni 11

Kompetencat e Komisionit të Disiplinës

Komisioni i disiplinës shqyrton kryesisht rastet e konstatuara nga komisioni i etikës dhe i sjelljes për shkeljet disiplinore të kryera nga ana e nxënësve, mësuesve dhe zëvendës drejtorëve.

Kur komisioni i disiplinës shqyrton rastin e shkeljes nga një anëtar i komisionit, ky anëtar nuk merr pjesë në mbledhjet e komisionit që shqyrton çështjen e tij.

Anëtarët e komisionit nuk janë pjesë e shqyrtimit dhe vendimmarrjes në rastet kur ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit. Para trajtimit të çdo rasti, secili anëtar duhet të deklarojë nëse ka apo jo konflikt interesi. Në rastet e konfliktit të interesit, komisioni do të zëvendësojë anëtarin përpara shqyrtimit të ankesës.

Në rast kur procedimi disiplinor kërkohet nga subjektet e tjera të legjitimuara, Komisioni pas verifikimit të saj dhe shkeljes së pretenduar vendos:

- a) Miratimin e fillimit të procedimit disiplinor;
- b) Mos fillimin e procedimit disiplinor, kur vlerëson që shkelja e pretenduar nuk parashikohet në kategorinë e shkeljeve të parashikuara në këtë rregullore.

Neni 12

Masa të pa aplikueshme

Ndalohen për t'u aplikuar në ofruesit e AFP-së, masat si më poshtë:

- a) masa që cenojnë dinjitetin e nxënësit;
 - b) dhuna fizike;
 - c) përjashtimi i pambikëqyrur nga mësimi i një nxënësi;
 - d) ndalimi për pjesëmarrje në veprimtaritë shkollore;
 - e) gjobot dhe dënimet monetare;
 - f) masa disiplinore kolektive për një grup nxënësish;
 - g) sekuestrimi përfundimtar ose për një kohë të gjatë i sendeve personale të ndaluara në shkollë, që u përkasin nxënësve, si: telefonat celularë, aparatura muzikore videogame etj.
- Mësuesi mund t'i kërkojë nxënësit t'i japë atij objektin në fjalë dhe duhet t'ia kthejë atë brenda një kohe "të arsyeshme" (fundit i ditës).

Neni 13

Llojet e shkeljeve disiplinore për nxënësit

Në këtë rregullore parashikohen dy lloj shkeljesh disiplinore për nxënësit e institucionit. Ato ndahen në:

- a) Shkelje të lehta;
- b) Shkelje të rënda;

Në varësi të llojit të shkeljes përcaktohet dhe masa disiplinore për shkelësin e normës disiplinore.

Neni 14

Shkelje të lehta

Do të konsiderohen si shkelje të lehta për nxënësit e institucionit rastet në vijim:

- a) Vonesa në frekuentimin ditor të procesit mësimor më shumë se 20 minuta (më shumë se 5 herë (pesë) gjatë semestrit në një lëndë;

- b) Mungesa e pajustificuar në procesin mësimor deri në 3 (tre) ditë rresht dhe 7 (shtatë) ditë në total në vitin mësimor;
- c) Diskutime verbale jo të përshtatshme me nxënësit e tjerë apo personelin e institucionit;
- d) Përdorimi i celularit gjatë mësimit jo për nevoja mësimore;
- e) Mosrespektimi i normave të veshjes brenda institucionit;
- f) Shkarravitja e mureve të institucionit;
- g) Kopjimi ose dhënia e kopjeve;
- h) Shpërdorimi i materialeve të siguruara nga institucioni gjatë procesit mësimor;
- i) Largimi nga ora mësimore.
- j) Bullizimi ndaj shoqeve dhe shokëve të shkollës

Neni 15 **Shkelje të rënda**

Do të konsiderohen si shkelje të rënda për nxënësit e institucionit rastet në vijim:

- a) Përsëritja e shkeljeve të lehta;
- b) Prishja e përsëritur e qetësisë në mjediset e shkollës;
- c) Ushtrimi i dhunës fizike dhe psikologjike ndaj dikujt;
- d) Krijimi i panikut në institucion me informacione ose veprime të rrema;
- e) Kërcënimi;
- f) Falsifikimi;
- g) Shpifja;
- h) Përdorimi i pijeve alkoolike apo narkotike brenda institucionit;
- i) Tentativa për të dëmtuar ose dëmtimi i pronës së institucionit apo materialeve në pronësi të institucionit;
- j) Tentativa për vjedhje ose vjedhja e pronës apo materialeve në pronësi të institucionit;
- k) Shpërndarja e lëndëve narkotike;
- l) Mbajtja e mjeteve që rrezikojnë jetën e të tjerëve ose përdorimi i tyre.
- m) Përdorimi i përsëritur (foto, video, video live) , i telefonit në procesin mësimor.

Neni 16 **Masat disiplinore për shkelje të lehta**

1. Masë disiplinore e lehtë për nxënësit e institucionit konsiderohet masa që zbatohet si një përgjigje e menjëhershme ndaj nxënësit, me qëllim reduktimin apo eliminimin e një sjelljeje të dëmshme të tij, e konsideruar si e tillë nga personeli arsimor.
2. Masat disiplinore të lehta kanë karakter informal dhe nuk shënohen në karakteristikë, në dosjen individuale të nxënësit apo në regjistër.
3. Masat disiplinore të lehta jepen nga mësuesi, kanë synim edukativ dhe parashikohen në rregulloren e brendshme të shkollës.
4. Në masat disiplinore të lehta përfshihen:
 - a) shënim në fletore për të cilin kërkohet nënshkrimi nga personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore;
 - b) ndjesë përpara klasës që synon të çojë në krijimin e vetëdijes për shkeljen e rregullave të kryera;
 - c) dhënia e detyrave shtesë në disiplinën përkatëse mbi një temë specifike.
 - d) Këto detyra shtesë mund të realizohen nga nxënësi në shtëpi apo edhe në shkollë. Për këtë lloj mase kërkohet edhe konfirmimi nga personi që ushtron përgjegjësinë prindërore. Detyrat shtesë të realizuara në institucionin shkollor duhet të realizohen nën vëzhgimin e mësuesit;

- e) mbajtja përtej orëve të mësimit të nxënësit të arsimit të mesëm profesional, për të kryer një punë në shërbim të shkollës (p.sh., kontribut në krijimin e këndeve lëndore apo në pastërtinë e klasës). Mbjtja e nxënësit në klasë jashtë orëve të mësimit nuk mund të jetë më shumë se një orë. Kjo realizohet me konfirmimin e personit që ushtron përgjegjësinë prindërore;
 - f) masa të tjera të lehta disiplinore të parashikuara në rregulloren e brendshme të IA-së.
 - 1. Këshillim
 - 2. Qortim
 - 3. Vërejtje
5. Përpara marrjes së masës disiplinore të lehtë është e domosdoshme që nxënësi të paraqesë versionin e tij të fakteve. Masa e lehtë disiplinore duhet të jetë proporcionale me shkeljet e kryera dhe të individualizuara, me qëllim që të garantojë efektivitetin e plotë edukativ.

Neni 17

Masa Disiplinore për shkelje të rënda

1. Masë disiplinore e rëndë për nxënësit e institucionit është masa që aplikohet ndaj nxënësit të arsimit të mesëm profesional për sjellje dhe veprime të rënda dhe të përsëritura, të cilat bien në kundërshtim me rregullat e parashikuara në funksion të procesit mësimor dhe jetës shkollore, në veçanti sjelljet e rënda ndaj personave dhe pronës.
2. Masat disiplinore të rënda kanë karakter administrativ dhe shënohen në karakteristikën e nxënësit dhe në dosjen e tij personale.
3. Masat disiplinore të rënda jepen nga komisioni i disiplinës.
4. Masa disiplinore e rëndë nuk aplikohet apriori, mbështetur vetëm në fajin, por edhe duke marrë në konsideratë personalitetin e nxënësit, si dhe kontekstin në të cilin është kryer shkelja.
5. Në masat disiplinore të rënda përfshihen:
 - a) **Paralajmërim për ulje të notës në sjellje:**
 - vendimi “Paralajmërim për ulje të notës në sjellje” realizohet me shkrim nga komisioni i disiplinës.
 - paralajmërimi për ulje të notës në sjellje u njoftohet me shkrim nxënësit dhe personave që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të tij apo përfaqësuesit të tij ligjor, të cilët duhet të konfirmojnë se kanë marrë dijeni për masën.
 - kjo masë disiplinore, e cila është pjesë e dosjes personale të nxënësit, shoqërohet, nëse është e nevojshme, nga një masë me natyrë edukative.
 - b) **Ulje e notës në sjellje:**
 - vendimi “Ulje e notës në sjellje” jepet vetëm për nxënësit e arsimit të mesëm të ulët dhe të arsimit të mesëm të lartë;
 - ulja e notës në sjellje u njoftohet me shkrim nxënësit dhe personave që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të tij apo përfaqësuesit të tij ligjor, të cilët duhet të konfirmojnë se kanë marrë dijeni për masën;
 - kjo masë disiplinore është pjesë e dosjes personale të nxënësit.
 - c) **Kontribut në shërbim të institucionit arsimor apo komunitetit:**
 - kjo masë u njoftohet me shkrim nxënësit dhe personave që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të tij apo përfaqësuesit të tij ligjor, të cilët duhet të konfirmojnë se kanë marrë dijeni;
 - kjo masë konsiston në kontributin e nxënësit jashtë orëve të mësimit, në veprimtari solidariteti, kulturore ose trajnuese, ose në kryerjen e një detyre për qëllime edukimi për një periudhë kohore të përcaktuar nga komisioni i disiplinës, që në total nuk i

kalon njëzet orë përgjatë vitit shkollor. Ky kontribut jepet brenda IA-së apo një autoriteti lokal, të mundësuar nga ZVA-ja;

- kjo masë disiplinore është pjesë e dosjes personale të nxënësit.

d) Përfundim i nxënësit nga institucioni arsimor:

- vendimi “Përfundim i nxënësit nga institucioni arsimor” jepet vetëm për nxënësit e arsimit të mesëm të lartë. Kjo masë konsiderohet si mënyra më ekstreme dhe mund të aplikohet vetëm pasi komisioni i disiplinës i IA-së ka shfrytëzuar (ezauruar) çdo mënyrë tjetër për të evituar procesin e përfundimit, duke i mundësuar nxënësit të dëshmojë vullnetin e tij për të ecur dhe për të reflektuar;
 - vetëm komisioni i disiplinës i IA-së ka kompetencën për marrjen e një mase të tillë;
 - njësi administrative bashkiake ku ka vendbanimin nxënësi, informohet për kohëzgjatjen e masës së rëndë disiplinore për përfundim të përkohshëm ose të përhershëm nga shkolla, në mënyrë që t’i jepet mundësia për të marrë masat e duhura sociale ose edukative brenda fushëveprimit të kompetencave të saj.
6. Komisioni i disiplinës i ofruarit të AFP-së ka të drejtë që të mos e aplikojë menjëherë masën disiplinore të rëndë dhe për zbatimin e saj mund të parashikojë një afat kohor, duke e paralajmëruar qartë nxënësin se përsëritja e veprimit nga ana e tij do të çonte (ta ekspozonte atë) në marrjen e vendimit për dhënien e masës përfundimtare.
 7. Komisioni i disiplinës i AFP-së -së mund të veprojë (investohet) edhe pa pasur një ankesë, në rastet e dhunës fizike ndaj një mësuesi.
 8. Komisioni i disiplinës i AFP-së -së mund të vendosë edhe krijimin e një grupi arsimor të përbërë nga mësues të institucionit, i cili hulumton dhe zhvillon një zgjidhje edukative të personalizuar.
 9. Çdo masë disiplinore duhet t’u shpjegohet nxënësit dhe personit që ushtron përgjegjësinë prindërore, duke u argumentuar atyre qëllimin e marrjes së masës.

Neni 18

Masat disiplinore për personelin mësimdhënës, zëvendës drejtorin dhe përgjegjësin e bazës prodhuese

1. Komisioni i disiplinës i institucionit jep masën disiplinore për mësuesin, zëvendës drejtorin ose përgjegjësin e bazës prodhuese, kur:
 - a) konstaton shkelje të legjislacionit në fuqi për arsimin dhe formimin profesional dhe arsimin parauniversitar, të kësaj rregulloreje ose të rregullores së brendshme të institucionit;
 - b) konstaton shkelje të dispozitave të Kodit të Etikës e të sjelljes në institucion;
 - c) konstaton rezultate fiktive të përsëritura të nxënësve, të verifikuara në mënyrë objektive, nëpërmjet testimeve të drejtorisë së institucionit apo rezultateve në provimet kombëtare;
 - d) konstaton mësuesi, zëvendës drejtori ose përgjegjësi i bazës prodhuese nuk kryen detyrat e tij sipas përshkrimit të tij të punës.
2. Masat e përshkallëzuara që komisioni i disiplinës vendos për mësuesin, zëvendës drejtorin ose përgjegjësin e bazës prodhuese, në varësi të llojit të shkeljes apo të përsëritjes së të njëjtës shkeljeje, janë:
 - a) këshillim
 - b) qortim
 - c) vërejtje;
 - d) paralajmërim për largim nga puna;
 - e) largim nga puna.

3. Në rastin e përsëritjes së shkeljes nga mësuesi, i cili për atë shkelje ka marrë më parë masën “Paralajmërim për largim nga puna”, komisioni i disiplinës i propozon drejtorit të ofruesit të AFP-së fillimin e procedurave për largimin nga puna të mësuesit.
4. Masa është e shlyer kur për një periudhë gjashtëmujore komisioni i disiplinës nuk ka shqyrtuar shkelje tjetër të mësuesit, zëvendës drejtorit ose përgjegjësit të bazës prodhuese.
5. Procedura për dhënien e masave disiplinore kryhet sipas Kodit të Procedurave Administrative.

Neni 19

Masat disiplinore për drejtorin e ofruesit të AFP-së

1. Titullari i AKPA-së ngre komisionin e disiplinës që shqyrton masën disiplinore për drejtorin e ofruesit të AFP-së. Komisioni përbëhet nga pesë anëtarë, të caktuar nga titullari.
2. Komisioni i disiplinës në AKPA propozon masën disiplinore për drejtorin e institucionit, kur konstaton:
 - a) shkelje të dispozitave të Kodit të Punës ose të legjislacionit të AFP-së dhe arsimit parauniversitar, të akteve të tjera nënligjore dhe të udhëzimit nr. 759, datë 30.9.2024, i ndryshuar;
 - b) shkelje të etikës e të sjelljes në institucion;
 - c) moskryerje të detyrave, sipas përshkrimit të punës;
 - d) rezultate të ulëta të ofruesit publik të AFP-së në provimet kombëtare;
 - e) rezultate të ulëta të performancës.
3. Masat që komisioni i disiplinës vendos për drejtorin, janë:
 - a) vërejtje;
 - b) vërejtje me paralajmërim për largim nga puna;
 - c) largim nga puna.
4. Komisioni i disiplinës shqyrton marrjen e masave disiplinore ndaj drejtorit të ofruesit publik të AFP-së me kërkesën me shkrim të drejtorit të përgjithshëm të AKPA-së ose të ekipit të monitorimit e vlerësimit, ose të mësuesve, të nxënësve të institucionit, të personave që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të nxënësve dhe çdo personi që ka hyrë me leje në institucion.
5. Trajtimi i sjelljeve të dhunshme të nxënësit ndaj mësuesit dhe personelit arsimor.

Neni 20

Fillimi i procedimit disiplinor

Procedimi disiplinor fillon kryesisht nga Komisioni i Etikes ose me kërkesë të subjektit të legjitimuar të miratuar nga Drejtuesi i institucionit.

Me depozitim të kërkesës në Komisionin, ky i fundit vendos për fillimin e procedimit hetimor si dhe njofton me shkresë palët e interesuara në këtë procedim.

Neni 21

Njoftimi për fillimin e procedimit disiplinor

Komisioni njofton me shkrim personelin e institucionit apo nxënësin për:

- a) Fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të tij. Njoftimi bëhet jo më vonë se 2 (ditë) nga marrja e vendimit për fillimin e procedimit;
- b) Shkeljen disiplinore të pretenduar;

- c) Të drejtën e shkelësit të pretenduar për të paraqitur me shkrim apo verbalisht sqarimet e tij/saj rreth shkeljes së pretenduar;
- d) Të drejtën për paraqitjen e provave të ndryshme nëse disponohen;
- e) Të drejtën për t'u dëgjuar. Në rast se shkelësi është nxënës në seancën e dëgjimit është e detyrueshme prania e psikologut apo punonjësit social të shkollës;
- f) Datën dhe orën kur do të shqyrtohet shkelja e pretenduar. Data nuk mund të caktohet më shpejt se 5 (pesë) ditë dhe jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga marrja e njoftimit për fillimin e procedimit.

Neni 22

Etapat e procedimit disiplinor

Procedimi disiplinor përfshin, shqyrtimin e ankesës, dëgjimin e palëve të përfshira, shqyrtimin e provave shkresore dhe marrjen e vendimit.

Ankesat/ raportimet anonime drejtuar Këshillit, nuk merren parasysh.

Procedura disiplinore deri në momentin e vendimmarrjes zgjat maksimalisht 30 ditë.

Komisioni në datën dhe orën e caktuar zhvillon seancën për shqyrtimin e procedimit disiplinor.

Kryetari i Komisionit çel seancën dëgjimore dhe të verifikimit të provave të depozituara.

Kryetari verifikon praninë e palëve.

Në seancën e procedimit disiplinore bëhet dëgjesa e palëve si dhe hetohen, shqyrtohen dhe vlerësohen faktet dhe provat e paraqitura.

Në mbledhjen e komisionit të disiplinës, kur trajtohet shkelja e rregullave disiplinore nga ana e nxënësit, merr pjesë nxënësi për të cilin shqyrtohet shkelja, mësuesi kujdestar i tij, psikologu apo punonjësi social, si dhe personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të nxënësit.

Çdo nxënës ka të drejtë të shoqërohet në mbledhje nga një "mbrojtës" i tij, që mund të jetë një person nga brenda ose jashtë shkollës, i zgjedhur nga personi që ushtron përgjegjësinë prindërore të nxënësit.

Pasi përfundon shqyrtimi i çështjes Komisioni tërhiqet për vendim.

Komisioni i disiplinës i merr vendimet me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të tij dhe me votim të fshehtë.

Neni 23

Procesverbali i mbledhjes

Procesverbali i mbledhjes mbahet nga Sekretari i emëruar me rotacion nga anëtarët e Komisionit. Procesverbali është zbardhja e gjithçka-je që trajtohet në mbledhje.

Procesverbali përmban:

- a) Datën dhe orën e mbledhjes;
- b) Identitetin e pjesëmarrësve në mbledhje;
- c) Çështjet që u diskutuan;
- d) Listën e provave të paraqitura.

Procesverbali duhet të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët.

Neni 24

Vendimi i Komisionit

Pas përfundimit të seancës dëgjimore, në bazë të dëshmive, provave dhe fakteve të paraqitura, Komisioni i disiplinës i merr vendimet me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të tij dhe me votim të fshehtë.

Vendimi i Komisionit përmban:

- a) Identitetin e anëtarëve të komisionit;
- b) Identitetin e shkelësit;
- c) Shkeljen/ shkeljet faktike;
- d) Bazën ligjore;
- e) Masën e vendosur;
- f) Arsyetimin e vendimit;
- g) Rastet e mëparshme të shkeljeve të ngjashme dhe të masave disiplinore;
- h) Nënshkrimet e të gjithë anëtarëve të komisionit;
- i) Numrin e votave pro dhe kundra për masën e marrë.

Vendimi i arsyetuar ju komunikohet palëve për njohje.

Neni 25

Ankimi

Ndaj vendimit të Komisionit, palët kanë të drejtë të bëjnë ankim brenda 3 (tre) ditëve nga komunikimi i vendimit.

Komisioni i disiplinës shqyrton ankimin brenda 3 (tre) ditëve nga data e depozitimit në protokollin e institucionit;

Ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e depozitimit të ankesës.

Neni 26

Regjistrimi i shkeljeve

Komisioni mban një regjistër për të gjitha shkeljet të cilat përfundojnë me masë disiplinore.

Në regjistër shënohen identiteti i palëve, shkelja disiplinore dhe masa e marrë përkatëse.

Regjistri i shkeljeve shërben për të identifikuar ekzistencën e shkeljeve të mëparshme nga personeli mësimor apo nxënësit dhe llojin e masës së marrë.

Shkeljet fshihen nga regjistri nga sekretari i Komisionit apo me kërkesë të palës së interesuar në përputhje me afatet ligjore të parashikuara në aktet nënligjore përkatëse.

Neni 27

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi me miratimin e saj nga drejtori i ofruesit publik të AFP-së.

DREJTOR I INSTITUCIONIT

Informacion për Dokumentin	
	SHKOLLA "HOTELERI-TURIZËM"
Emërtimi i Dokumentit	Rregullore Komisionit Disiplinor
Miratuar nga:	Drejtori i institucionit
Data e miratimit	03 /09/2025
Numri i vendimit	278
Numri i faqeve	12
Data e hyrjes në fuqi	03 /09/2025
Shpërndarja	Për përdorim të brendshëm
Kodi i dokumentit	RRKD-03-SH2025